

STATUT I SHOQERISE "SOLAR" shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me **22/06/2023**, unë:

Edmond Idrizi shtetas shqiptar, i biri i Veli dhe Deje, datëlindja 05/01/1973, lindur në Elbasan dhe banues në Durrës, me adresë Rruga Nikolin Xhoja Njesia; Nd. Nd.7992; Durrës; 2006, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034574822 dhe nr. personal H30105070S

ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, vendosa të miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

Neni 1 **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më **22 /06/2023**, unë, themeluesi i mësipërm, themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "**SOLAR**" sh.p.k.

Neni 2 **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Ndertimi dhe projektimi i objekteve të prodhimit të energjisë diellore, shitja me shumicë dhe pakicë paneleve fotovoltaike, import eksport i paneleve fotovoltaike si dhe materialeve ndertimore që lidhen me ndertimin e parqeve fotovoltaike, import eksport i materialeve të ndertimit dhe mjeteve të transportit të rënde, prodhimi i energjisë elektrike, tregtimi i energjisë elektrike, furnizimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike ndaj të tremeve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, dhënia, marrja me qira, shitje-blerje e tokave për zhvillimin e parqeve fotovoltaike, ndertimi dhe menaxhimi i zonave ekskluzive tregtare për zhvillimin e parqeve fotovoltaike si dhe do të gjejë tjetër që lejohet legjislacioni shqiptar në fuqi për tregtare dhe shoqëritë tregtare. Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri në bazë të legjislacionit shqiptar. Çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë direkt dhe indirekt dhe që i shërben përmbushjes së aktiviteteve si më lart.

Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.



Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar**.

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Nikolin Xhoja Njesia; Nd. Nd.7992; Durrës; 2006, Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 100.000 (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Edmond Idrizi** : Zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme ALL 100.000 që përben **100% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do të ketë një numer proporcional votash me vleren nominale të kuotes se tij.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe të shoqëritë kontrolluese dhe/ose të grupit të caktuara me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund të kalohen te të tretet vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, që jepet nepermjet një vendimi të marë me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III



ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te paktën një here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratorët dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë se Pergjithshme mund te dërgohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorëzuar Shoqerise me kalimin e ditës se 7-te pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si me sipër duhet te

përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës. Ortaket mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakeve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Te gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 10 **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë të shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Edmond Idrizi** shtetas shqiptar, i biri i Veli dhe i Deje, datëlindja 05/01/1973, lindur në Elbasan dhe banues në Durrës, me adresë Rruga Nikolin Xhoja Njesia; Nd. Nd.7992; Durrës; 2006, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034574822 dhe nr. personal H30105070S

- *pa kufizime në kompetencat e administrimit.*

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblesë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SOLAR" sh.p.k

Edmond Idrizi

Edmond Idrizi
